



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 8 maj 2014, në mbledhjen II – të (dytë)të Komitetit për komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.20.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmet, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama, z. Radisav Perović, z. Shaban Ahmeti, z. Shaban Osmani, Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Fadil Babatinca, Stacioni i Policisë në Podujevë, z. Bekim Karaxhija, OSBE **dhe Norbert Bulejka, LMT**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19 mars 2014

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozim Plani i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2014

z. Shaban Osmani, e lexi propozimin e Planit të punës.

Në vazhdim, për detyra veç e veç u diskutua në formë dialogu dhe pas shqyrtimit, njëzëri u pajtuan me ndryshimet si vijon:

- Shqyrtimi propozimit të Planit të punës për vitin 2014, në vend të muajit prill vizita të bëhet Maj,
- Vizitë e komuniteteve pakicë dhe shkollës fillore në fshatin Batllavë, i shtohet dhe Orllan dhe në vend të muajit korrik, kjo vizitë të bëhet në qershor
- Identifikimi i nxënësve të komuniteteve pakicë të cilët e kanë ndërprerë (i shtohet fjala eventualisht) shkollimin dhe ndërmarrja e veprimeve përfshirjen e tyre në procesin mësimor, objektiv i renditur pas shtatori, bartet në muajin qershor Në kuadër të kësaj bartet edhe detyra e paraparë për muajin nëntor:
- Identifikimi i personave të komuniteteve pakicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin e mesëm dhe ndërmarrja e veprimeve përfshirjen e tyre në

procesin mësimor joformal për përfundimin e klasave përkatëse.

- Shqyrtimi i raportit të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, çdo gjashtë Muaj, riformulohet:
- Shqyrtimi i Informatave të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, sipas nevojës.

z. Muharrem Haziri, OSBE, theksoi, jeni në dijeni se procesi i përgatitjes së buxhetit për vitin 2015, përkatësisht Kornizës Afatmesme Buxhetore 2015-2017, nis në fillim të qershorit andaj duke u bazuar në këtë sugjerimi im është që vizitat të cilat i keni paraparë t'ua bëni komuniteteve pakicë t'i realizoni sa më parë ngase gjatë vizitave do t'ju paraqiten kërkesa të cilat kanë implikime financiare dhe nëse veproni në këtë mënyrë ju në emër të Komitetit për Komunitete do të keni mundësi të dilni me kërkesa konkrete para miratimit të projektbuxhetit.

Plani i punës u miratua njëzëri me korrigimet e përshkruara.

4. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50’.

Prosesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01-006-54917

Podujevë,

8 maj 2014

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**